



**USAID**  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



MACEDONIAN  
CENTER FOR  
INTERNATIONAL  
COOPERATION



Instituti për demokraci  
Societas Civilis - Shkup



## Perceptimet për korrupsionin dhe motivimi për angazhim në luftën kundër korrupsionit

Konkluzione nga fokus grupet e realizuara



# IMPRESUM

**Titull:** Perceptimet për korrupsionin dhe motivimi për angazhim në luftën kundër korrupsionit - Konkluzione nga fokus grupet e realizuara

**Botues:** Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

**Autor:** Marija Dimitrovska

**Përkthimi:** Vjosa Taipi

**Dizajni:** Dejan Kuzmanovski

Publikimi mund të shkarkohet falas nët:

<http://www.idscs.org.mk/>

Ky publikim është përgatitur nga Instituti për Demokraci Societas Civilis në kuadër të programit Qytetarët kundër korrupsionit me mbështetje të popullit Amerikan përmes Agjencionit për Zhvillim Ndërkombëtar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USAID). Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë medoemos pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

# PËRMBAJTJE

<b>GJETJET KRYESORE</b>	<b>4</b>
<b>OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA</b>	<b>6</b>
<b>I. KORRUPSIONI PËRMES PIKËPAMJEVE TË PJESËMARRËSVE</b>	<b>7</b>
Asociacione/shembuj të korrupsionit	8
Informimi për korrupsionin	9
Arsyet për korrupsion	9
Kush është i ekspozuar ndaj korrupsionit?	10
Çfarë ndikimi ka korrupsioni?	10
Përvojat dhe arsyet për (mos)raportimin e korrupsionit	11
Institucionet në luftë kundër korrupsionit	12
<b>2. MOTIVIMI DHE PENGESAT PËR PJESËMARRJE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT</b>	<b>14</b>
Rekomandime nga qytetarët	16
<b>REZYME</b>	<b>18</b>

# GJETJET KRYESORE

- Asociacionet kryesore rreth korrupsionit për pjesëmarrësit është korrupsioni i lartë, megjithëse përvoja e tyre e drejtpërdrejtë është në fushën e korrupsionit të vogël. Ekziston një konsensus se korrupsioni është një problem i madh shoqëror; se përhapja dhe mosndëshkimi i tij ka një ndikim destruktiv mbi shoqërinë
- Qasja e vështirë në shërbime dhe në shërbime cilësore, nga njëra anë, si dhe të ardhurat e ulëta dhe vendosja e marrëdhënieve korruptive si “të pritura”, nga ana tjetër, janë vënë në dukje si faktorët kryesorë për mbijetesën e korrupsionit. Sa më i rëndësishëm të jetë sektori për mirëqenien e qytetarëve, aq më i madh është presioni i korrupsionit. Kjo, sipas pjesëmarrësve, dëmton funksionalitetin e institucioneve, përforcon mosbesimin, ndikon në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe është faktor në shpërnguljen e atyre që refuzojnë të jetojnë me këtë realitet.
- Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe besojnë se raportimi i korrupsionit është i padobishëm, sepse ata nuk presin që rastet e korrupsionit të hetohen dhe sanksionohen siç duhet, kanë frikë nga pasojat ose janë përballur me pasoja kur kanë raportuar korrupsionin. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), organizatat e sektorit civil, Prokuroria Publike, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Avokati i Popullit, si dhe inspektoratet dhe Këshilli Gjyqësor konsiderohen institucione kyçe në luftën kundër korrupsionit. Megjithatë, ka besim të ulët në kapacitetet e këtyre institucioneve për të trajtuar me sukses korrupsionin.
- Një numër i vogël i pjesëmarrësve të grupeve të fokusit marrin pjesë në organizata vullnetare jashtë shtëpisë ose punës, ku vërehet mungesë e motivimit për të marrë pjesë në aksione (individuale apo masive) për luftë kundër korrupsionit. Faktorët kryesorë motivues për pjesëmarrje në protesta janë rëndësia e problemit për të cilin është organizuar protesta, pakënaqësia me situatën aktuale, si dhe nevoja për të “vepruar moralisht”. Janë të zhgënjyer nga mungesa e efektit nga këto veprime në të kaluarën që ndikon në dekurajimin për angazhim në veprime të ngjashme në të ardhmen.
- Rekomandime për hartimin e iniciativave për përfshirje më të madhe të qytetarëve në luftën aktive kundër korrupsionit:
  - o Sipas pjesëmarrësve, ndryshimi personal nuk mund të ketë një ndikim më të gjerë shoqëror nëse nuk është masiv. Në këtë drejtim, është e nevojshme të organizohen veprime/iniciativa/produkte komunikimi që synojnë të rrisin solidaritetin kolektiv dhe të bëjnë thirrje për luftë për interesin e përbashkët, duke theksuar masivitetin si një faktor për ndryshim. Përfshirja e organizatave lokale grassroot, të cilat gëzojnë besimin e qytetarëve, në mobilizimin e rezistencës qytetare ndaj korrupsionit, mund të kontribuojë në përfshirje më të madhe qytetare.

- o Perceptimi se ka një ndryshim pozitiv (rastet e zgjidhura të korrupsionit, ndryshimi i kuadrit normativ) është një faktor motivues; informimi dhe theksimi i rezultateve të arritura në luftën kundër korrupsionit do të ndikonte në rritjen e besimit dhe motivimit të qytetarëve për të marrë pjesë në aksione kundër korrupsionit.
- o Një faktor i rëndësishëm motivues për pjesëmarrësit është ndjenja e sigurisë se ata janë të sigurt nga pasojat nëse shprehin publikisht një pozicion/mendim. Rritja e vazhdueshme e ndërgjegjësimit për kanalet e disponueshme për raportimin anonim të korrupsionit, siç është informimi për rezultatet pozitive të korrupsionit të raportuar, do të ndikonte në besimin e qytetarëve në zgjidhjet sistematike për luftë kundër korrupsionit
- o Sipas diskutimeve në suazat e grupeve të fokusit, ekziston nevoja për edukim të vazhdueshëm në lidhje me shërbimet për të cilat kanë të drejtë qytetarët, si dhe edukim në lidhje me të drejtat e tyre në situata të caktuara, veçanërisht në fushat ku korrupsioni i vogël është i zakonshëm (shëndetësi, marrja e dokumenteve personale dhe lejeve, etj.). Kështu, duke treguar mënyrat në të cilat korrupsioni dëmton disponueshmërinë e të drejtave dhe shërbimeve për të gjithë, mund të kontribuojë në zvogëlimin e tolerancës për sjelljen korruptive.

# OBJEKTIVAT DHE METODOLOGJIA

Qëllimi i hulumtimit cilësor është sigurimi i informacioneve në lidhje me perceptimet e qytetarëve për korrupsionin, si dhe më shumë njohuri si për motivet ashtu edhe për pengesat për pjesëmarrjen e tyre aktive në luftën kundër korrupsionit. Hulumtimi cilësor kryhet në kuadër të programit «Qytetarët kundër korrupsionit», i financuar nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar në Republikën e Maqedonisë së Veriut (USAID), e udhëhequr nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar në partneritet me Institutin për Demokraci «Societas Civilis» – Shkup (IDSCS), Qendrën për Komunikime Civile (QKC), Odën Ekonomike të Maqedonisë së Veriut (OKMV), 360 gradë, Laboratori i Raportimit Investigativ (IRL) dhe Rrjetin Ballkanik të Gazetarëve Hulumtues, Maqedoni (BIRN). Konkluzionet e analizës do të përdoren për të hartuar, planifikuar dhe organizuar iniciativa për përfshirje më të madhe të qytetarëve në luftën aktive kundër korrupsionit.

Për qëllime të analizës, u zhvilluan tetë fokus grupe me gjithsej 80 qytetarë nga të gjitha rajonet e vendit, një fokus grup në secilin rajon. Gjatë formimit të grupeve, u bënë përpjekje për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor midis pjesëmarrësve. Grupet e fokusit u zhvilluan midis 10 dhe 25 gushtit 2023. Pjesëmarrësit diskutuan disa tema në lidhje me korrupsionin – çfarë përbën korrupsionin për ta, si ndikon korrupsioni në shoqëri, kush janë institucionet kryesore të prekura nga problemi i korrupsionit, si dhe cilat janë pikëpamjet e tyre mbi rolin e qytetarëve dhe aktorëve të ndryshëm në zgjidhjen e problemit të korrupsionit.

# I. KORRUPSIONI PËRMES PIKËPAMJEVE TË PJESËMARRËSVE

Pjesëmarrësit nga të gjitha rajonet ishin të gatshëm dhe të hapur për të ndarë pikëpamjet e tyre mbi atë që paraqet korrupsioni. Përkufizimet e zakonshme të korrupsionit brenda diskutimeve e paraqesin atë si një marrëdhënie që përfshin dhënien e ryshfetit (para ose shërbim) për marrjen e një shërbimi të kërkuar, ose marrjen e shërbimit të nevojshëm në një afat më të shkurtër kohor ose me cilësi më të mirë.

Nga diskutimet konkludohet se pjesëmarrësit e kuptojnë korrupsionin si një avantazh të paautorizuar në marrjen e një shërbimi të caktuar dhe se kjo marrëdhënie përfshin shkeljen e normave ligjore dhe shpërdorimin e detyrës. Shpesh, në përshkrimet e korrupsionit, pjesëmarrësit e vendosin këtë marrëdhënie në lidhje me mungesën e vlerave morale midis personave të përfshirë në korrupsion. Për më tepër, shumica është e mendimit se korrupsioni është diçka që është e përhapur dhe e normalizuar si fenomen shoqëror. Pjesëmarrësit u përgjigjën, se megjithëse janë të vetëdijshëm për atë që përbën korrupsion dhe besojnë se ai ndikon jashtëzakonisht keq në shoqëri, shpesh është vërtet e vështirë t'i shpëtosh presionit për të marrë pjesë në korrupsion, sepse në shumë sfera korrupsioni është shndërruar në mënyrë funksionimi. Në përshkrimet e korrupsionit, një pjesë e madhe e pjesëmarrësve theksojnë rrethin e mbyllur të korrupsionit, përkatësisht menjëherë sapo të merret një shërbim në mënyrë jostandarde, atëherë qëndron “borxhi” i kundër-shërbimit.

**“Është si një duhanpirës të pyesni, të gjithë duhanpirësit do të pajtohen se cigaret janë të këqija dhe të dëmshme, por megjithatë ende pini duhan”.**

*(mashkull, i papunë, rajoni Verilindor)*

Gjatë gjithë diskutimeve, mund të vërehet tendenca e pjesëmarrësve për të bërë një dallim moral në qëndrimin e tyre ndaj formave të ndryshme të korrupsionit – korrupsioni i vogël dhe i lartë, si dhe të theksojnë dilemat – nëse nepotizmi është korrupsion, rastet kur nuk jepet ryshfet ose favor i menjëhershëm për marrjen e trajtimit të privilegjuar (por është reciprok nëse dhe kur pala tjetër e kërkon atë). Duke bërë dallimin se cila sjellje është korrupsion dhe cila jo, pjesëmarrësit shpesh refuzuan aktet e të ashtuquajturit korrupsion i vogël si sjellje që nuk duhet të reduktohet në termin korrupsion. E tillë ishte, për shembull, pikëpamja e disa pjesëmarrësve se punësimi partiak nuk përbën akt korrupsion sepse (sipas tyre) nuk përfshin kompensim të menjëhershëm për shërbimin e kryer.

Dilema të tjera në lidhje me marrëdhëniet korruptive janë të lidhura edhe me praktikën e dhënies së dhuratave për një shërbim të kryer, veçanërisht kur ato nuk janë kërkuar drejtpërdrejt nga pala që ka kryer shërbimin. Pjesëmarrësit bëjnë një dallim midis dhënies së dhuratave të vogla (kafe, ëmbëlsira) dhe dhuratave të shtrenjta (bizhuteri, pije alkoolike luksoze, etj.). Disa pjesëmarrës bëjnë një dallim plotësues për sa i përket dhënies së një dhurate dhe dhënies së parave. Duke qenë se pothuajse të gjithë pjesëmarrësit ofruan dhe pranuan përcaktimin e korrupsionit si shkelje të normave për marrjen e trajtimit të privilegjuar për shkak të një kompensimi të caktuar, imponohet interpretimi se disa prej tyre “amnistojnë” këtë formë korrupsion duke e paraqitur atë si

një mënyrë funksionimi “të normalizuar”, siç është kërkimi i lidhjeve për marrjen e dokumenteve, ose dhënien e një dhurate. Në një farë mënyre, krijohet përshtypja se dikush minimizon përgjegjësinë personale (brenda kuadrit të pjesëmarrjes në korrupsion të vogël) në kurriz të korrupsionit të lartë, i cili në perceptimet e shumicës së pjesëmarrësve është i kudondodhur dhe një faktor për mbijetesën e korrupsionit të vogël.

**“Ndodhitë e përditshme, bisedat e përditshme me njerëz, nga të gjitha anët, ky korrupsion nuk fshihet më në vendin tonë se ekziston, që them se tani nëse është shoqja juaj, ose një mik apo një i afërm ose ju vetë e dini për shembull se sa keni nevojë, nëse doni një mjek më të mirë ose nëse doni ta kryeni punën tuaj më shpejt ju e dini se si të mbaroni punë në gjykatë ju e dini se si të mbaroni punë në polici, kemi ardhur tashmë në një stad edhe në dyqan nëse keni nevojë të merrni diçka dhe atje keni nevojë për korrupsion”.**

*(grua, sektor privat, rajoni Verilindor)*

Edhe në situatat kur pjesëmarrësit pranojnë se format e vogla të ryshfetit përfaqësojnë korrupsion, paraqesin “pashmangshmërinë” e këtyre marrëdhënieve për të mbështetur “mentalitetin ballkanik”, për llojet e marrëdhënieve që përcillen nga brezi në brez. Argumente të njëjta ose të ngjashme përdoren në shpjegimin e përhapjes së korrupsionit, se është një lloj sjelljeje që «është shumë e vështirë ose nuk mund të refuzohet» sepse është pjesë e marrëdhënieve që kanë mbijetuar në shoqërinë tonë gjatë gjithë historisë. Pasoja e kësaj është një sistem në të cilin është pothuajse e pamundur të kesh qasje në shërbime (me cilësi të përshtatshme) në mënyrë të rregullt, ligjore, një rreth “vicioz” që “shtyn” qytetarët në pranimin dhe ndërmarrjen e mënyrave alternative (shpesh të paligjshme dhe të korruptuara) për qasje në shërbime. Një nga faktorët kryesorë për përhapjen e gjerë të korrupsionit, sipas pjesëmarrësve, është fakti se institucionet që janë kompetente për të luftuar korrupsionin janë vetë të ekspozuar ndaj korrupsionit, ku ndjeshmëria ndaj korrupsionit është drejtpërdrejt proporcionale me sasinë e pushtetit që ka një institucion/pozitë.

## **1.1 Asociacione/shembuj të korrupsionit**

Duke përmendur shembuj të korrupsionit, pjesëmarrësit shpesh së pari i referohen rasteve të korrupsionit të lartë ose deklarojnë se korrupsioni është i lidhur kryesisht me organet më të larta të pushtetit. Nga rastet e korrupsionit të lartë, midis pjesëmarrësve nga disa fokus grupe, u përmend rasti i kontratës për ndërtimin e autostradave nga Korridori 8 midis Qeverisë dhe kompanisë Bechtel-Enka. Në disa fokus grupe, asociacioni i parë për korrupsion ishin rastet në fushën e shëndetësisë, nga caktimi i kontrolleve deri te intervenimet për kushte kërcënuese për jetën. Gjithashtu të shpeshtë ishin shembuj të korrupsionit në procedurat administrative, si marrja e dokumenteve personale dhe marrja e lejeve. Shembujt e cituar përfshinin korrupsionin në nivel lokal, në gjyqësor, prokurime publike, punësim, ndërtim, kalimin e kufirit, korrupsion në arsim. Pjesëmarrësit cituan shembuj kur ata ishin kushtëzuar në mënyrë të tërthortë ose të drejtpërdrejtë për ryshfet, pavarësisht nga situatat kur ata vetë ofruan ryshfet.

Ndër shembujt personalë të pjesëmarrjes në korrupsion ishin marrja e një provimit për lejen për drejtim të automjetit, hyrja jashtë rendit, kërkimi i shërbimeve shëndetësore përmes të njohurve, kërkimi i intervenimit për nota. Në korrupsionin e vogël, shembuj të favorizimit për shërbim ose përdorimi i marrëdhënieve me miqtë dhe të njohurit për të marrë shërbim më të shpejtë ose me cilësi më të mirë janë të zakonshme. Ata



që marrin pjesë në korrupsion shpesh përdorin mungesën e kompensimit financiar të aktit korruptiv për të mohuar se dhënia e paligjshme e privilegjeve është korrupsion.

## 1.2 Informimi për korrupsionin

Burimet kryesore të informimit për korrupsionin e pjesëmarrësve janë mediat (ndër këto shumë shpesh internet portalet), por edhe përvoja personale dhe përvoja e të afërmeve dhe miqve (“marrim pjesë në to”). Disa nga pjesëmarrësit deklaruan se ata gjithashtu marrin informacion në lidhje me korrupsionin përmes mbulimit mediatic të punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

## 1.3 Arsyet për korrupsion

Pjesëmarrësit diskutuan arsyet e ndryshme për të cilat palët individuale në marrëdhënien korruptive do të kishin një motiv për t'u përfshirë në këto veprime. Nga ana e atyre që ofrojnë ose pranojnë të japin ryshfet, një nga faktorët kryesorë ishte mungesa e qasjes në shërbime, veçanërisht në kohë dhe shërbime cilësore si shkak i korrupsionit (rrit presionin nga korrupsioni). Nga ana e personave që kërkojnë ose pranojnë të marrin ryshfet, borxhi i kundër-shërbimit dhe mungesa e financave përmenden si arsye për korrupsion.

Faktori mundësues për korrupsionin, sipas pjesëmarrësve në disa fokus grupe, janë paqartësitë dhe interpretimet e ndryshme të normave ligjore.

**“Kur ligji nuk funksionon, ku ka pikë dhe presje në ligj që 10 persona e interpretojnë ndryshe, nuk e di se ligje të tilla ekzistojnë në Perëndim”.**

*(burrë, punëtor me honorar, rajoni i Pellagonisë)*

Për më tepër, diskutimet në disa fokus grupe theksuan nivelin e ulët të ndërgjegjësimit të qytetarëve për sa i përket të drejtave dhe detyrimeve që ata gëzojnë/kanë, si dhe nivelin e lartë të apatisë të qytetarët si faktorë që inkurajojnë dhe mundësojnë korrupsionin.

**“Pse besoj se korrupsioni nuk do të zgjidhet? Mbi të gjitha, korrupsioni ka nevojë për dy veta, një që kërkon dhe një që ofron ryshfet. Këtë e kemi në vendin tonë. Çdo i treti maqedonas do të thoshte, “po, do të jepja para”. Gjëja e dytë është se ne jemi shumë të varfër me njohuri. Vështirë se dikush e di se cili institucion është përgjegjës për çfarë, cili ligj ju jep, cilën të drejtë, ku mund të ankoheni, si mund të merrni një të drejtë. Shumë rrallë. Gjëja kryesore është se “nuk do të bëni asgjë, nuk ka kuptim të përpiqeni.” Ne për 20 vjet jemi dehur me këngën: “mos u shqetëso, edhe ashtu nuk do të bësh asgjë”. Ne tashmë këtë e kemi si predispozitë gjenetike. Më parë ishte “kokën e përkulur shpata nuk e pret”, dhe tani është “nuk mund të bësh asgjë gjithsesi”. Dhe kjo është arsyeja pse nuk bëjmë asgjë”.**

*(grua, e papunë, rajoni i Pellagonisë)*

Sa më i rëndësishëm të jetë sektori për mirëqenien e qytetarëve, aq më i madh është presioni i korrupsionit, mendojnë pjesëmarrësit. Në të gjitha grupet e fokusit, u përmendën përvojat nga shëndetësia, ku nga shërbimet/ndërrhyrjet e vogla deri tek intervenimet kërcënuese për jetën, pjesëmarrësve iu është kërkuar ryshfet. Shëndetësia kryesisht u përmend më shpesh si asociacioni i parë për korrupsionin dhe shpesh u theksua si fusha në të cilën mbizotëron korrupsioni më së shumti.

#### **1.4 Kush është i ekspozuar ndaj korrupsionit?**

Në kuadër të diskutimit rreth shembujve të korrupsionit, pjesëmarrësit tashmë kishin veçuar sektorët/institucionet që ata i konsideronin më të ekspozuar ndaj korrupsionit – shëndetësia, policia, gjykatat. Përveç këtyre, pjesëmarrësit brenda grupeve të caktuara të fokusit përmendën Qeverinë, doganën dhe Drejtorinë e të Ardhurave Publike (DAP), si dhe shërbimin kombëtar të mediave – Radio Televizionin e Maqedonisë (RTVM). Gjyqësori dallohet si një sferë të cilit i është besuar mbrojtja dhe sanksionimi i korrupsionit dhe njihet si vendimtar në luftën kundër korrupsionit.

Në diskutimet nëse korrupsioni mbizotëron midis një kategorie të caktuar demografike, shumë pjesëmarrës nuk e konsiderojnë sjelljen korruptive si karakteristike të të rinjve (deri në 30 vjeç) dhe besojnë se të moshuarit janë më të prirë të kërkojnë ose ofrojnë ryshfet për shërbim. Ky perceptim mund të jetë ose për shkak të kuptimit të korrupsionit si një praktikë e trashëguar e së kaluarës (kështu që të moshuarit tashmë e kanë pranuar atë dhe janë në përputhje me modelin e marrëdhënieve korruptive) ose paraqet një funksion të pushtetit, ku njerëzit e moshuar/më me përvojë që e gjejnë veten në një pozitë pushteti, e keqpërdorin atë përmes korrupsionit.

Në përgjithësi, nuk kishte mendime se gjinia paraqet një faktor në sjelljen korruptive. Pjesëmarrësit ishin të mendimit se pavarësisht nga gjinia, korrupsioni ishte më i lidhur me pozicionin e një personi. Në disa nga fokus grupet, u shprehën mendime të ndara se anëtarët e grupeve të tjera etnike (gjithmonë të shprehur për një grup etnik të ndryshëm nga grupi të cilit i përkasin) janë më të prirë për korrupsion dhe se ata kontribuojnë në përkeqësimin e problemit të korrupsionit.

#### **1.5 Çfarë ndikimi ka korrupsioni?**

Pjesëmarrësit pajtohen se korrupsioni është një problem i madh shoqëror; se përhapja dhe mosndëshkimi i tij ka një ndikim shkatërrues mbi shoqërinë dhe cilësinë e jetës së qytetarëve. Nga ana tjetër, korrupsioni perceptohet si një fenomen i normalizuar, duke u bërë një zgjidhje për aspekte të ndryshme të funksionimit të përditshëm.

Pjesëmarrësit në diskutime theksuan se korrupsioni shkakton «vuajtje financiare» të qytetarëve dhe rrit pakënaqësinë sociale. Me korrupsionin, shërbimet e vështira për t'u arritur bëhen edhe më të papërbalueshme për qytetarët që nuk mund të japin ryshfet; kur bëhet fjalë për shërbime nga të cilat varet shëndeti dhe jeta e qytetarëve, disponueshmëria e vështirë mund të bëjë dallimin midis jetës dhe vdekjes. Kjo, theksuan pjesëmarrësit, dëmton funksionalitetin e institucioneve (qasja e dobët në shërbime, shërbime jocilësore, mungesa e sundimit të ligjit, ndikim negativ mbi mjedisin jetësor), përforcon mosbesimin, ndikon në cilësinë e jetës së qytetarëve dhe është faktor në emigrimin e atyre që refuzojnë të jetojnë me këtë realitet.

“Shumicën e kohës e di se si. Këta njerëz i kapin në një marrëdhënie emocionale. Kur kanë më shumë probleme, kur duhet të bëjnë më shumë punë për x, x arsye. Njeri nuk mendon atëherë të raportojë, ai mendon vetëm si ta përfundojë punën. Një gjë tjetër është se korrupsioni ka hyrë në kulturën tonë të sjelljes. Në një farë mase, ne mendojmë se është normale të japësh për të kryer një punë. Dhe prandaj nuk guxojmë ta raportojmë. Nëse raportojmë dhe nëse nxjerrin një, dy, tre, pesë, nuk do t'i kemi këta njerëz për ta kryer këtë punë dhe ky është tashmë një problem i shoqërisë. [...] Punonjësit institucionalë janë të prirë ndaj korrupsionit, kryesisht për shkak se pagat janë të ulëta. Sepse me ato paga, ata nuk mund të kenë thjesht një jetesë normale. Pra, ata janë të dënuar, fatkeqësisht, të ndërhyjnë në fatet e njerëzve. Njerëzit që nuk mund t'ia dalin, por do të japin 100 euro për ta bërë kryer punën dhe për një muaj të tërë do të hanë bukë dhe kripë, që themi ne. Vetëm të mbarohet puna. Këtu, si njerëz dhe si krijesa, mendoj se nuk jemi fer. Nuk janë fer ata që janë të prirë ndaj korrupsionit në institucione, por për fat të keq ky është sistemi. Sistemi është vështirë të ndryshohet, veçanërisht në vende si i yni, në tranzicion. Një gjë tjetër është se së pari duhet të kemi një mekanizëm në nivel lokal, dhe pastaj në nivel shtetëror, sikur në një farë mënyre të paktën të çrrënjoset korrupsioni dhe normalisht duhet të ketë gjithnjë e më shumë edukim dhe gjithçka që quhet edukim i popullatës kundër gjithë kësaj. Megjithatë, mendoj se do të duhet një kohë e gjatë, shumë e gjatë për të kryer punë pa dhënë asgjë”.

*(mashkull, i punësuar në administratën publike, rajoni Jugperëndimor)*

Për më tepër, pjesëmarrësit besojnë se korrupsioni, në formën e nepotizmit dhe punësimeve partiake, si dhe emigrimi i popullsisë së re dhe të arsimuar, përkeqëson problemin e mungesës së stafit të kualifikuar dhe kompetent në institucione, duke rritur në mënyrë indirekte presionin e korrupsionit. Sipas tyre, korrupsioni ndikon edhe në humbjen e investimeve të huaja si dhe marrëdhëniet me partnerët e huaj në sektorin e biznesit. Së fundi, efekti kumulativ i të gjitha këtyre pasojave ka ndikim edhe në përkeqësimin e shëndetit mendor të qytetarëve, të cilët përballen me presione të rregullta të heshtin ose për të përfshihen në sjellje korruptive për të funksionuar.

## **1.6 Përvojat dhe arsyet për (mos)raportimin e korrupsionit**

Shumica e pjesëmarrësve të grupeve të fokusit nga të gjitha rajonet e konsiderojnë raportimin e korrupsionit si të kotë, pasi ata nuk presin që rastet e korrupsionit të hetohen dhe sanksionohen në mënyrë përkatëse. Në shumicën e rasteve kur pjesëmarrësit e rrallë raportuan korrupsion, ata u përballën me pasoja (të tilla si humbja e vendit të punës, ndikimi negativ në karrierë, etj.). Disa prej tyre kanë reaguar duke shkruar peticione, duke raportuar në institucionet kompetente, por mungesa e reagimit të autoriteteve kompetente i demoralizon. Mund të konkludohet se midis pjesëmarrësve nuk ka perceptim për kapacitetin për veprim personal, kapacitetin e qytetarëve të jenë aktorë aktivë në çrrënjosjen e korrupsionit.

**“Dhe në fund, mund të dalësh fajtor, ndërsa ai të cilin ke dashur të raportosh nuk do të dënohet. Dhe kjo është arsyeja pse njeriu i zakonshëm nuk reagon. Jeton me këtë realitet”.**

*(grua, profesoreshë, rajoni i Pollogut)*

Përveç mosbesimit ndaj institucioneve, në disa fokus grupe, pjesëmarrësit deklaruan se nuk kishin raportuar korrupsion nga frika e pasojave. Shpesh, pjesëmarrësit theksonin se ndihen të pafuqishëm kur duhet të raportojnë korrupsionin, sepse "korrupsioni mbrohet dhe në zinxhir të gjithë janë të korruptuar dhe drejtësi nuk mund të ketë."

Të përballur me pasojat në raportimin e korrupsionit, ekziston një besim midis pjesëmarrësve se nuk ka asnjë mekanizëm që mbron qytetarët dhe të drejtat e tyre gjatë raportimit anonim, si në aspektin e mbrojtjes së identitetit të sinjalizuesit, ashtu edhe në aspektin e rezultatit të raportimit/rastit.

**“Frika se nëse raportoni dikë, do të digjeni në vend të atij që duhet të raportoni. Dhe mund të të kthehet kundër dhe të të mbyllin ty”.**

*(mashkull, punëtor në sektorin privat, rajoni i Vardarit)*

**“Është e vështirë të raportosh korrupsionin sepse të gjithë janë të ndërlidhur. Dhe në fund do të dalësh përsëri fajtor. Dhe në fund do të përfundosh pa punë, në varësi të vendit ku je. Një njeri nuk mund të luftojë një përbindësh, krimin. Krimi është një përbindësh. Dhe ti si individ ku mund të luftosh. Nuk mundesh. Do të heshtësh ose do të kërkosh mënyrat tuaja alternative për të arritur njëfarë drejtësie dhe në fund nëse mund të kompensohesh. Pra, të gjithë jemi vetëm. Secili e përballon në mënyrën e vet”.**

*(grua, e papunë, rajoni i Pollogut)*

## **I.7 Institucionet në luftë kundër korrupsionit**

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) njihet si një institucion me mandat antikorrupsion midis shumicës së pjesëmarrësve në fokus-grupe. Megjithatë, përveç njohjes themelore të ekzistencës së institucionit, shumica e pjesëmarrësve nuk ndanë më shumë informacion në lidhje me mandatin ose rezultatet e KSHPK-së, te disa prej pjesëmarrësve ekziston mendimi se KSHPK-ja është një autoritet për sanksionimin e korrupsionit, dhe te disa pjesëmarrës kishte pasiguri në lidhje me statusin e KSHPK-së (nëse është një organizatë shtetërore apo joqeveritare). Disa nga pjesëmarrësit kanë informacion në lidhje me mundësinë e raportimit të korrupsionit me telefon, dhe një pjesë më e vogël se korrupsioni mund të raportohet në vetë institucionet (ku u kërkohet ryshfet). Disa, kryesisht pjesëmarrës më të rinj, përmendën organizatat e shoqërisë civile (Komiteti i Helsinkit, OJQ Glasen Tekstilec) si organizata të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Ndër institucionet e tjera të identifikuara si të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit ishin Prokuroria Publike, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, Drejtoria e të Ardhurave Publike, Avokati i Popullit, si dhe Inspektoratet dhe Këshilli Gjyqësor. Drejtuesit e institucioneve shtetërore u përmendën gjithashtu si pozicione që kanë qasje në informacion, përfshirë korrupsionin, dhe të cilët kanë fuqi të ndërmarrin veprimet e duhura për ta parandaluar dhe sanksionuar korrupsionin. Pjesëmarrësit përmendën besimin e ulët në kapacitetin e këtyre institucioneve për të luftuar me sukses korrupsionin. Ata besojnë se autoritetet gjyqësore nuk veprojnë në bazë të dyshimeve të arsyeshme për korrupsion dhe se rastet e hapura nuk marrin zgjidhje adekuate.

Kur bëhet fjalë për mediat, pjesëmarrësit, përveçse i konsiderojnë si burim informacioni për rastet e mundshme të korrupsionit, shumica me skepticizëm të madh i referohen kontributit të mediave në luftën kundër korrupsionit. Diskutimet nxjerrin në pah pikëpamjen e disa prej pjesëmarrësve se shumica e mediave janë të njëanshme dhe i shërbejnë interesave të një strukture të caktuar politike dhe ekspozojnë në mënyrë selektive rastet që lidhen me kundërshtarët e tyre politikë, gjë që gjithashtu mund të krijojë konfuzion midis qytetarëve. Diskutimet rreth mundësisë që media të kontribuojë në luftën kundër korrupsionit diskutuan se megjithëse në krahasim me të kaluarën, tani ka më shumë liri për të raportuar dhe komentuar, media në përgjithësi nuk shihet si një forcë që mund të kontribuojë për të bërë ndryshim për mirë.

## 2. MOTIVIMI DHE PENGESAT PËR PJESËMARRJE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Në përgjithësi, shumë pak pjesëmarrës të grupeve të fokusit marrin pjesë në organizata vullnetare jashtë shtëpisë ose punës. Disa nga pjesëmarrësit që punojnë në sektorin publik deklaruan se ata shmangin përfshirjen në protesta nga frika e shënjestrit në vendin e punës. Për më tepër, pjesëmarrësit nga rajonet rurale theksojnë se kanë më pak mundësi për pjesëmarrje në komunitet, në mjediset në të cilat jetojnë.

Në diskutime u vu re edhe një hendek ndërmjet brezash në qëndrimet e pjesëmarrësve - pjesëmarrësit më të moshuar besojnë se të rinjtë janë apatikë dhe i përgjigjen korrupsionit dhe problemeve të tjera sociale duke u larguar nga vendi. Nga ana tjetër, të rinjtë besojnë se janë shumë më aktivë se bashkëqytetarët e moshuar, por nuk shohin mbështetje nga ana e tyre.

Një numër i vogël pjesëmarrësish e ndejnë për detyrë të marrin pjesë në protesta ose të angazhohen në mënyrë tjetër në luftën kundër korrupsionit. Ata përmendin si faktor motivues dëshirën për drejtësi dhe një cilësi më të mirë të jetës. Të pyetur për faktorët që do t'i motivonin për të dalë në protesta, pjesëmarrësit kryesisht përmendën rëndësinë e problemit për të cilin organizohet protesta, pakënaqësinë me situatën aktuale, si dhe presionin për të "vepruar moralisht".

Një pjesë më e vogël e pjesëmarrësve (shumica femra) deklaruan se kishin marrë pjesë në protesta për çështje të ndryshme shoqërore në të kaluarën, përfshirë protestat për rastet e korrupsionit. Janë të zhgënjyer nga mungesa e efektit nga këto veprime që ndikon në dekurajimin për angazhim në veprime të ngjashme në të ardhmen. Kur bëhet fjalë për aftësinë e tyre për të vepruar si qytetarë, u paraqitën propozime që bëjnë thirrje për vetë-organizim qytetar (për shembull, formimi i një qendre për raportim të korrupsionit qytetar) që do t'i inkurajonte të jenë proaktivë në luftën kundër korrupsionit.

Mënyrat shtesë për të luftuar korrupsionin për të cilin u diskutua përfshinin tërheqjen nga pjesëmarrja personale në aktivitete korruptive, raportimin e aktiviteteve korruptive dhe bojkotimin e proceseve zgjedhore. Pjesëmarrësit i konsiderojnë masat në luftë si një faktor motivues dhe kërkojnë një konsensus më të gjerë kundër korrupsionit në shoqëri.

Theksojnë se disponueshmëria më e madhe e shërbimeve të caktuara do t'i ndihmojë qytetarët të kërkojnë më pak mënyra alternative (korruptive) për të arritur këto shërbime. Gjykimet për rastet e korrupsionit që janë zgjidhur konsiderohen gjithashtu si një faktor motivues që qytetarët të jenë më aktivë në raportimin e korrupsionit.

Për shumicën e pjesëmarrësve, arsimit nuk është faktor që kontribuon ndjeshëm në luftën kundër korrupsionit dhe dominohet nga pikëpamjet për arsimin si të korruptuar dhe me cilësi të dobët. Shumë pjesëmarrës në diskutime besojnë se sistemi arsimor nuk u mëson të rinjve mendimin kritik, por mbështet të mësuarit përmes përsëritjes dhe promovon nënshtrimin. Megjithatë, ka ndërgjegjësim midis pjesëmarrësve për rolin e rëndësishëm edukativ të arsimit, ndërsa në këtë kontekst rolin në luftën kundër korrupsionit. Megjithëse ata besojnë se arsimit ka fuqi të rritë ndërgjegjësimin për problemin e korrupsionit, aktualisht sistemi arsimor nuk e përmbush këtë rol sepse nuk mund të distancohet nga sistemi që është jashtëzakonisht i ekspozuar ndaj korrupsionit. Të pyetur për mundësinë e uljes së presionit të korrupsionit mbi arsimin, disa nga pjesëmarrësit përmendën si mundësi testimin e standardizuar dhe provimet pranuese për një nivel më të lartë të arsimit. Pjesëmarrësit gjithashtu patën mundësi të ndajnë njohuri rreth sukseseve në luftën kundër korrupsionit. Shumica e deklaratave përfshijnë vendet e tjera (Singapori, Belgjika, Franca), ku vërehet se nuk ka detaje në lidhje me strategjitë që janë ndërmarrë në luftën kundër korrupsionit. Në shumicën e rasteve, nuk jepen detaje për shembujt dhe deklaratat përcjellin idenë se një zgjidhje ligjore/juridike mjafton për të zgjidhur problemin e korrupsionit sistematik. Për sa i përket aktivizmit masiv, përmendet shembulli i Francës, ku pakënaqësia e publikut për probleme të ndryshme (përfshirë korrupsionin) shprehet përmes protestave masive.

**“Siç kam hulumtuar, e di se Singapori konsiderohej si një nga sistemet më të korruptuara politike, shëndetësia. Me miratimin e Ligjit, i gjithë vendi u riorganizua në një mënyrë. Pikërisht me miratimin e ligjeve dhe duke provuar pasurinë, mjetet financiare, kudo që është zbuluar të paktën një përqindje e vogël e korrupsionit të njerëzve, të cilat nuk mund të provonin nga ku është pasuria e tyre, pasuritë e fituara dhe të ngjashme. Të gjithë përfunduan në rrugë dhe kështu u krijua një sistem i ri dhe tani Singapori është një nga vendet më të pasura dhe më të rregulluara në botë“.**

*(femër, studente, rajoni Juglindor)*

Kuptimi se një aksion ka pasur rezultat ose se ndryshimet për të mirë kanë filluar të ndjehen në një sektor të caktuar, për pjesëmarrësit është një faktor i fortë motivues, që dhe vetë të jenë më të zëshëm kundër korrupsionit.

**“Sikur ta dija se do të arrija diçka duke raportuar. Pra, nëse në fillim mendoj se nuk do të bëj asgjë, çfarë më tutje.**

*(femër, sektori shtetëror, rajoni Verilindor)*

Një faktor i rëndësishëm motivues për pjesëmarrësit është ndjenja e sigurisë se ata janë të sigurt nga pasojat nëse shprehin publikisht një pozicion/mendim. Disa nga pjesëmarrësit deklaruan se u përmbajtën nga pjesëmarrja në ngjarje publike kundër korrupsionit nga frika e përballjes me pasojat në vendin e punës (administrata publike). Kjo ide se pjesëmarrja e tyre (individualisht ose në grup) i karakterizon ata politikisht dhe mund të ketë ndikim në karrierën e tyre, por edhe në mirëqenien e përgjithshme.

**“Dhe presioni social. Ja unë para se të vij i them gruas do të shkoj në fokus grup për korrupsionin. E dini çfarë më tha gruaja ime... Kujdes çfarë flet“.**

*(mashkull, i punësuar në sektorin shtetëror, rajoni i Shkupit)*

Polarizimi (politik dhe etnik) perceptohet si pengesë për masivitetin në përgjigje të korrupsionit. Disa nga pjesëmarrësit ndanë se entuziazmi dhe besimi i tyre në ndryshime u është rrënuar pasi Revolucion i laraman, sipas tyre, nuk ka dhënë rezultatet e pritshme në çrrënjosjen e korrupsionit. Përveç kësaj, një numër i vogël i pjesëmarrësve përmendën Marrëveshjen Kornizë të Ohrit si një faktor të mobilizimit etno-politik që nuk lejon unifikim më masiv në luftën kundër korrupsionit.

## **2.1 Rekomandime nga qytetarët**

Pjesëmarrësit bien dakord se është i nevojshëm profesionalizimi dhe forcimi i kapaciteteve të të gjitha institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit. Përveç kësaj, ekziston një shkallë e lartë pajtimi se është e nevojshme të sigurohet respektimi i ligjeve dhe qasja e barabartë në të drejta dhe shërbime për të gjithë qytetarët. Në disa fokus grupe, u theksua veçanërisht se ata që janë në krye të hierarkisë duhet të japin një shembull duke respektuar ligjet, në mënyrë që të ketë një efekt zinxhir përposhtë. Në disa raste, pjesëmarrësit bënë thirrje për monitorim më të madh nga komuniteti ndërkombëtar dhe ekspertizë të jashtme për ballafaqim me korrupsionin.

Pjesëmarrësit shprehen se depolitizimi i shoqërisë do të ndihmonte në motivimin e qytetarëve për angazhim në luftën kundër korrupsionit. Masiviteti i reagimeve kundër korrupsionit (protesta, për shembull) vepron si një faktor motivues. Me masivitet zvogëlohet frika nga pasojat.

Për sa i përket fushatave kundër korrupsionit, shumë pjesëmarrës nuk i konsiderojnë ato të dobishme (i konsiderojnë ato si "fjalë boshe"). Është e rëndësishme që të shohin ndëshkueshmëri dhe llogaridhënie më të madhe të institucioneve.

Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve deklarojnë se shoqëria ka nevojë për një figurë të fortë udhëheqëse, si dhe dënime rigoroze që do të demotivonin marrëdhëniet e ardhshme të korrupsionit. Disa nga pjesëmarrësit besojnë se përfshirja e institucioneve fetare mund të ndihmojë, përmes rolit moral dhe edukativ të këtyre institucioneve. Promovimi i vlerave kryesore, të cilat nuk janë të ndryshme midis religjioneve, mund të ndihmojë në luftën kundër korrupsionit.

Së fundi, shumica e pjesëmarrësve besojnë se ndryshimi personal, shembulli personal, nuk mund të ketë ndikim shoqëror nëse nuk është masiv.

Rrjedhimisht me besimin se sistemi gjyqësor është një faktor kyç në përhapjen dhe thellësinë e korrupsionit në shoqëri, pjesëmarrësit bëjnë thirrje për reforma në gjyqësor që do të mundësojnë pavarësinë e gjyqësorit. Nëpërmjet diskutimeve në lidhje me faktin se bartësit e mëparshëm të funksioneve për të cilët procedurat për shpërdorim të mundshëm të detyrës në marrëdhëniet korruptive janë kryer prej vitesh, deri më sot "bredhin të lirë", pa epilog gjyqësor të rasteve. Për disa nga pjesëmarrësit, miratimi i një ligji për origjinën e pasurisë është një nga mënyrat për të ushtruar kontroll më të madh mbi korrupsionin.



Së fundi, pjesëmarrësit rekomandojnë që transparencja më e madhe e institucioneve, jo vetëm në gjyqësor, por në të gjitha sferat, do të kishte një ndikim pozitiv në drejtim të zvogëlimit të presionit të korrupsionit mbi institucionet. Kur qytetarët e dinë se lënda e tyre është në procedurë, deri ku është lënda, do të kishte më pak motiv për të ofruar ryshfet. Në këtë kontekst, edukimi për cilat shërbime kanë të drejtë qytetarët, si dhe edukimi për të drejtat e tyre në situata të caktuara, gjithashtu mund të jetë një pjesë e dobishme e një fushate. Theksimi i ndikimit të keq të korrupsionit të vogël që bëjnë shpesh qytetarët (nëse kaloni pa radhë, të tjerët dëmtohen) duhet të përdoret gjithashtu për të rritur ndërgjegjësimin në një fushatë.

**“Mendoj se edhe procedurat duhet të bëhen pak më transparente, të themi për shembull kur hyn të lësh një fletë dhe kur institucioni shndërrohet në vrimë të zezë dhe më duhet të pres 5 muaj që të dalë diçka, të dihet për shembull, një dokument i caktuar ku është për momentin”.**

*(mashkull, Ministri, i punësuar në sektorin shtetëror, rajoni i Shkupit)*

Pjesëmarrësit, për më tepër, besojnë se vendosja e llogaridhënies midis bartësve të pushtetit duhet të lidhet me korrupsionin; përkatësisht, se qeveritë duhet të mbajnë përgjegjësi për klimën e pafavorshme për korrupsionin.

**“Le t’i inkurajojmë ata në Qeveri ta bëjnë këtë, të parandalojnë korrupsionin duke kërcënuar kolltukun e tyre. Të miratohet ligj, nëse në nivel vjetor korrupsioni është shembull në krye, ne jemi në 5 vendet e para me korrupsion më të lartë, ai grup politikanësh nuk mund të kandidojë në zgjedhjet e ardhshme. Dhe nëse ka rezultate më të mira, atëherë kandidoni ne do të votojmë. Nëse jemi më të këqij me korrupsionin, ata nuk kanë të drejtë të kandidojnë në zgjedhje”.**

*(mashkull, student, rajoni i Vardarit)*

Ekspertët jo-partiakë që do të merrnin pjesë në mobilizimin e rezistencës civile ndaj korrupsionit është një rekomandim nga disa prej pjesëmarrësve nga rajoni i Vardarit. Për më tepër, përfshirja e organizatave lokale që do të kishin besimin e qytetarëve dhe do të tregonin rezultate.

# REZYME

Nga analiza e opinioneve të pjesëmarrësve në fokus grupet për çështje të ndryshme, mund të konkludohet se masivizimi i veprimeve kundër korrupsionit ka një efekt motivues në shumicën e tyre që të angazhohen/mbështesin në mënyrë aktive këto përpjekje. Njoftimi se rastet e korrupsionit janë identifikuar dhe sanksionuar gjithashtu ndikon pozitivisht në motivimin për të vetë-raportuar ose për të mbështetur aktivitetet për luftë kundër korrupsionit. Një faktor i rëndësishëm motivues për pjesëmarrësit është ndjenja e sigurisë se janë të sigurt nga pasojat nëse shprehin publikisht një qëndrim/mendim; sipas këtij konstatimi, informimi i rregullt i qytetarëve për kanalet e disponueshme për raportim anonim të korrupsionit, por edhe shkëmbimi i informacioneve për rastet e zgjidhura të korrupsionit do të ndikonte në rritjen e besimit të qytetarëve në zgjidhjet sistematike për luftë kundër korrupsionit.

